

AUTORITETET SHQIPTARE URDHËROHEN TË OFROJNË UJË TË PASTËR PËR ROMËT PAS RASTIT TË DISKRIMINIMIT



Tiranë, Budapest 12 dhjetor 2018: Një komunitet rom në Fushë-Krujë, Shqipëri, ka fituar një rast përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi iu kundërvu bashkisë vendore për refuzimin për t'iu ofruar ujë të pastër të pijshëm dhe higjienë. Komisioneri gjeti se Bashkia e Krujës kishte diskriminuar ndaj familjeve rome që jetonin në lagjen “Kastriot” në bazë të etnisë dhe statusit ekonomiko-social të tyre, dhe urdhëroi bashkinë të ndërmarrë masa të menjëhershme për ta korrigjuar situatën ose të përballej me një gjobë.

Rasti u dërgua tek Komisioneri nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), me mbështetjen e Qendrës Europiane për të Drejtat e Romëve (ERRC), të cilët ofruar provat për ndarjen etnike në aksesin ndaj ujit në Shqipëri.

Avokatja e ERRC Nicole Garbin tha, *“Mungesa e ujit të pijshëm dhe kushteve higjieno-sanitare është një çështje që prek romët kudo në Europë. Është një prej mënyrave më të ashpra dhe më të rrezikshme të manifestimit anti-rom.”*

Garbin vazhdoi, *“Kërkimet tona tregojnë se romët përballen në mënyrë rutinore me diskriminim në ofrimin e ujit të pastër, pavarësisht se organet ndërkombëtare e njohin dhe sanksionojnë atë si të drejtë të njeriut. Ky vendim thjesht kërkon që autoritetet të përmbushin detyrimin e tyre për të ofruar një nevojë njerëzore bazë për akses në ujë dhe higjenë.”*

Rreth 250 familje rome (1,200 persona) jetojnë në komunitetin i cili ka ekzistuar prej fundit të viteve 1990-të dhe ka vuajtur gjatë nga mungesa e ujit të pastër. Një projekt i drejtuar nga një organizatë rome vendase në vitin 2005 dëshmoi furnizimin me ujë në zonë por që u ndërpre nga bashkia pak kohë më pas. Banorët e lagjes “Kastriot” që nga ajo kohë janë detyruar të shpojnë puse private për të siguruar ujë nga toka. Megjithatë, uji i lumit i ndotur nga ndotjet urbane përzihet me ujin e puseve dhe në vitin 2014 çoi në shpërthimin e Hepatitit A, sidomos mes fëmijëve. Ndonëse kjo u bë lajm dhe autoritetet ishin në dijeni të epidemisë shëndetësore, autoritetet shtetërore nuk morën asnjë masë.

Kompania e ujësjellës-kanalizimeve e kontraktuar për të siguruar furnizimin me ujë në bashki argumentoi se linjat e furnizimit arrijnë deri tek komuniteti rom, por ngaqë nuk ka pasur banorë që të shprehnin interesin në pikën e lidhjes, ata e kishin përmbushur detyrimin e tyre ligjor për të ofruar ujë.

“Furnizimi me ujë është një e drejtë e njeriut dhe në Shqipëri është një shërbim publik” tha Rovena Vuksani nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. *“Komania e ujësjellësit detyrohet me ligj ta përmbushë këtë shërbim dhe nuk mund të refuzojë në mënyrë arbitrare që t’i ofrojë ujë një lagjeje të tërë. Ky vendim është një hap i rëndësishëm drejt njohjes dhe kapërcimit të diskriminimit institucional me të cilin romët përballen në Shqipëri. Do të monitorojmë veprimet e bashkisë me kujdes gjatë 30 ditëve të ardhshme për t’u siguruar që do të ndërmarrin masa urgjente për të siguruar ujë të pastër.”*

Ky njoftim për shtyp gjendet edhe anglisht.

Për më shumë informacion, apo për të organizuar një intervistë, kontaktoni:

Rovena Vuksani
Juriste
Komiteti Shqiptar i Helsinkit
rovena.vuksani@ahc.org.al
+355682023699

Jonathan Lee
Koordinator Komunikimi
Qendra Europiane për të Drejtat e Romëve
Jonathan.lee@errc.org
+36 30 500 2118